



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:108222
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05508476

Ac.nr.3556/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.R., kundër të paditurit L.D. nga fshati, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson F.B., avokat në Pejë, sipas autorizimit, për rimbursimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.140/18, datë 09.03.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.140/18, i datës 09.03.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.140/18, të datës 09.03.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur si në vijim:

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, Rr “Lidhja e Pejës”, Magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, p.n, me të cilin ka kërkuar që të: detyrohet i padituri L.D., që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit t’i rimbursoj shumën prej 695.00 euro në emër të rimbursimit të dëmit të

shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 29.09.2013 në Pejë dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës të cilat do t'i caktoj kjo gjykatë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, për shkak të parashkrimit.

- II. Detyrohet paditësja që të paditurit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 239 euro brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e paditëses në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin dhe ta aprovoj kërkesëpadinë apo aktgjykimin ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i të paditurit ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditëses si e pabazuar dhe të vërtetohet në tërësi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarës së saj, me datë 16.02.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për rimbursimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të I. Miratohet kërkesëpadia e paditëses, Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, si e bazuar, II. Detyrohet i paditur L.D. që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit t'i rimbursoj shumën prej 695 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 29.09.2013, në Pejë dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie deri në pagesën përfundimtare si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës të cilat do t'i caktoj kjo gjykatë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të- të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.140/18, të datës 09.03.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit në fjalë.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të provave të administruara rezulton se paditësja ka ra në vonesë për të kërkuar regresin e shumës së paguar në emër të shpërblimit të dëmit për të dëmtuarin nga aksidenti i komunikacionit të shkaktuar nga i padituri. Në mbështetje të konstatimit për parashkrimin e kërkesës nga padia, gjykata i është referuar fakteve dhe provave vendimtare të rastit, nga të cilët vërtetohet se paditësja me të dëmtuarin, me datë 05.01.2015, ka lidhur ujdinë jashtgjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumë prej 695€, e cila shumë të dëmtuarit i është paguar me datë 15.01.2015, ashtu siç vërtetohet nga urdhërtransferi bankar i datës 15.01.2015. Kështu, me referim në datën e arritjes së ujisë jashtëgjyqësore dhe përmbushjes së detyrimit të paditëses në raport me të dëmtuarin, gjykata erdhi

në përfundim që padia për regres e ushtruar me datë 16.02.2018, kundër të paditurit është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor trevjeçar siç përcaktohet me dispozitat e nenit 357 të LMD.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 357 paragraf 1 të LMD-së, lidhur me nenet 7, 143 paragraf 1 dhe 319 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenet 449, 452 paragraf 1 dhe 463 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i vërtetuar të gjitha rrethanat, përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar dhe si e tillë e njëjta duhet të refuzohet. Deri te ky përfundim gjykata ka ardhur duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se

Me nenin 341 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Me parashkrim shuhet e drejta e kërkit të përmbushjes së detyrimit ”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se “ Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit ”.

Me nenin 342 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Me nenin 357 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë në dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se kërkesa për rimbursimin e dëmit ndaj të paditurës është parashkruar, për arsye se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 29.09.2013, pagesa për shpërblimin e dëmit palës së dëmtuar i është bërë me datë 15.01.2015, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë me datë 16.02.2018, e nga kjo rezulton se nga momenti i pagesës (që nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse) me të cilën është kompensuar pala e dëmtuar, e deri në paraqitjen e padsisë në gjykatë kanë kaluar 3 vite e një muaj, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3556/20, me datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli